

MacN3twork, shpk

Pasqyrat Financiare

në datë 31 Dhjetor 2018

Përmbajtja

Pasqyra e performancës	3
Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto	5
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	6
Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare	7
1 <i>Informacion i përgjithshëm</i>	7
2 <i>Baza e përgatitjes dhe politikat kontabël</i>	7
3 <i>Ofrim shërbime marketingu</i>	8
4 <i>Shpenzime të personelit</i>	8
5 <i>Rezultati i periudhës</i>	8
6 <i>Mjetet monetare</i>	9
7 <i>Detyrime tatimore</i>	9
8 <i>Parimi i vijimësisë</i>	9
9 <i>Miratimi i pasqyrave financiare</i>	9

MacN3twork, shpk

Pasqyra e performancës Për periudhën që mbyllet në datë 31.Dhjetor.2018

	Shënime	Periudha e mbyllur 31.Dhjetor.2018 (Lekë)	Periudha e filluar 18.Maj.2018 (Lekë)
i. Të ardhurat			
.....	3	0	0
Total të ardhura (i)		0	0
ii. Shpenzimet			
Shpenzime të personelit	4	-204,967	0
Total shpenzime (ii)		-204,967	0
Rezultati nga veprimtaria kryesore (i-ii)		-204,967	0
iii. Shpenzime financiare			
...		0	
Total shpenzime financiare (iii)		0	0
Rezultati para tatimit (i-ii-/+iii)		-204,967	0
Shpenzimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin	5	0	0
Rezultati neto i periudhës	5	-204,967	0

Kamil Pawel Chomski
Administrator

Kamil Chomski



MacN3twork, shpk

Pasqyra e pozicionit financiar në datë 31.Dhjetor.2018

	Shënime	31.Dhjetor.2018 (Lekë)	18.Maj.2018 (Lekë)
I. AKTIVET			
i. Aktivet Afatshkurtra			
Mjetet monetare	6	777	0
Total aktive afatshkurtra (i)		777	0
Total Aktive (i)		777	0
II. DETYRIME DHE KAPITALI			
ii. Detyrimet Afatshkurtra			
Detyrime ndaj punonjësve	4	155,965	
Detyrime tatimore	6	49,002	0
Total detyrime afatshkurtra (ii)		204,967	0
Total Detyrime (ii)		204,967	0
iii. Kapitali			
Kapitali ligjor		777	
Rezultati i periudhës	5	-204,967	0
Total kapitali (iii)		-204,190	0
Total Detyrime dhe Kapitali (ii+iii)		777	0

Kamil Pawel Chomski
Administrator

Kamil Chomski

Ka



MacN3twork, shpk

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto Për periudhën që mbyllet në datë 31.Dhjetor.2018

	Shënime	Kapitali ligjor (Lekë)	Rezultati i pacaktuar (Lekë)	Totali (Lekë)
18.Maj.2018		0	0	0
Krijimi i kapitalit ligjor		777	0	777
Humbja e periudhës	5		-204,967	-204,967
31.Dhjetor.2018		777	-204,967	-204,190



Kamil Pawel Chomski
Administrator

Kamil Chomski
Ka

MacN3twork, shpk

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare Për periudhën që mbyllet në datë 31.Dhjetor.2017

Shënime	Periudha e mbyllur 31.Dhjetor.2018 (Lekë)	Periudha e filluar 18.Maj.2018 (Lekë)
i. Fluksi monetar përdorur nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Të paguara për detyrimet e pagueshme dhe detyrimet ndaj punonjësve	0	0
Tatim fitimi i thjeshtuar mbi fitimin	0	0
Rrjedha e parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit (i)	0	0
ii. Fluksi monetar përdorur për veprimtaritë investuese		
....	0	0
Paraja e përdorur në aktivitetet e investimit (ii)	0	0
iii. Fluksi monetar nga aktivitetet financiare		
Krijimi i kapitalit ligjor	777	
Rrjedha e parasë nga aktivitetet e financimit (iii)	777	0
Rënia neto e mjeteve monetare	777	0
Mjetet monetare në fillim të periudhës	0	0
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	0	0
Mjetet monetare në fund të periudhës	777	0

Kamil Chomski

Ka



Kamil Pawel Chomski
Administrator

FutureNet™
UNLIMITED LIFE!

Politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare

(Të gjitha shumatat në Lekë, përveç nëse është cilësuar ndryshe)

1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria MacN3twork, shpk është krijuar si person Juridik në datë 18.Maj.2018, me numër unik L81722034V. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 777 lekë me ortak të vetëm Kamil Pawel Chomski, i cili zotëron 100 % të kuotave. Kapitali ligjor i shoqërisë nuk ka ndryshuar nga regjistrimi fillestar.

Adresa e regjistruar dhe vendndodhja e aktivitetit është në Rruga Myslym Shyri, Pallati 8, Shkalla 3, Apartamenti 9, Tiranë.

Veprimtaria e tij rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit 9901 date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria është krijuar me qëllim ushtrimin e veprimtarisë së saj në fushën e ofrimit të shërbimeve të marketingut (kryesisht online) dhe shërbimeve të tjera të ngjashme.

Gjatë vitit 2018 shoqëria nuk ka arritur të kryejë aktivitet ekonomik. Kjo periudhë ka shërbyer për studimin e tregut dhe mundësitë që ofron ky aktivitet në vendit tonë.

Pavarësisht, dëshirës për të krijuar këtë aktivitet, drejtuesit e saj janë duke shqyrtuar edhe mundësinë e tërheqjes përfundimtare nga ky aktivitet. Megjithatë, këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e vijimësisë sepse njësia i ka mjetet e nevojshme për të mbuluar të gjitha detyrimet e saj.

2 Baza e përgatitjes dhe politikat kontabël

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me *Standartet Kombëtare të Kontabilitetit* në Shqipëri (SKK) të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Në rastet kur SKK nuk parashikojnë çështje të veçanta, janë zbatuar parashikimet në *Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme*. Pasqyrat janë paraqitur në Lekë.

Këto pasqyra përgatiten për herë të parë dhe përshijnë periudhën ushtrimore 2018 nga data 18.Maj.2018.

2.1. Bazat e matjeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatin financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara).

2.2. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë shumatat neto, pasi janë zbritur shumatat e mbledhura për llogari të palëve të treta, siç mund të jenë tatimi mbi vlerën e shtuar dhe taksa të tjera të shitjes. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, neto nga skontimet dhe taksat përkatëse të shitjes.

2.3. Tatimi mbi të ardhurat

Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat paraqet shumën e tatimit aktualisht të pagueshëm. Tatimi aktualisht i pagueshëm bazohet në fitimin e tatueshëm për vitin.

2 Baza e përgatitjes dhe politikat kontabël (vazhdim)

2.4. Instrumentet financiare

Instrumentet financiare përfshijnë llogaritë bankare, para në dorë, llogaritë e arkëtueshme, parapagimet dhe llogaritë e pagueshme. Të gjithë instrumentet financiare janë njohur në pasqyrat financiare me kosto.

3 Ofrim shërbime marketingu

Njësia ekonomike është krijuar në datë 27.Shtator.2018 dhe nuk ka realizuar të ardhura nga ofrimi i shërbimeve apo të ardhura të tjera.

Kjo kohë ka qenë e nevojshme për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për vijimin e veprimtarisë ekonomike dhe karakterin stinor të kësaj veprimtarie.

4 Shpenzime të personelit

	Periudha e mbyllur 31.Dhjetor.2018
Paga personeli	175,636
Shpenzim sigurime punonjës	29,331
Totali	204,967

Numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese është 1 punonjës . Në mbyllje të pasqyrave financiare detyrimi për punonjësit e shoqërisë është 155,965 Lekë.

5 Rezultati i periudhës

Më poshtë tregohet analiza e rezultatit të realizuar gjatë periudhës raportuese.

	Periudha e mbyllur 31.Dhjetor.2017
Fitimi para tatimit	-204,967
a. Shpenzime të pazbritshme	0
Baza e llogaritjes së tatimit	-204,967
	< 5 milion Lekë
Tatim fitimi i thjeshtuar mbi fitimin	0%
Fitimi neto	-204,967

Shoqëria është objekt i llogaritjes së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në përputhje me parashikimet e nenit 11, pika 2 të ligjit Nr. 9632, date 30.10.2006 *Për sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar.

6 Mjetet monetare

Njësia nuk ka zhvilluar aktivitet ekonomik apo financiar gjatë periudhës. Mjetet monetare përbëhen nga gjendja e arkës, e krijuar nga kapitali ligjor i shoqërisë.

7 Detyrime tatimore

Në këtë zë është paraqitur detyrimi i njësisë për pagesën e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në shumën 49,002 Lekë (shënimi 4).

8 Parimi i vijimësisë

Në muajin Dhjetor 2018, drejtuesit e shoqërisë kanë shprehur objeksionet për mbylljen e shoqërisë, për shkak të pamundësive të zhvillimit të veprimtarisë ekonomike. Në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave, ende nuk është ndërmarrë ndonjë nismë ligjore për të vijuar me procedurat e mbylljes.

9 Miratimi i pasqyrave financiare

Këto pasqyra janë miratuar dhe autorizuar për t'u publikuar më 29.Janar.2019.

